

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" nisi me sukses Javën Ndërkombëtare Erasmus+

Në një ceremoni të veçantë, përfaqësues të arsimit, diplomacisë dhe komunitetit akademik u mbledhën për të çelur këtë javë të rëndësishme që feston bashkëpunimin ndërkombëtar dhe mundësitë e shkëmbimit kulturor.

Rektorja e Universitetit, Prof. dr. Elvira Fetahu, në fjalën e saj, theksoi rëndësinë e ruajtjes së vlerave akademike dhe kulturore, si dhe rolin e universitetit si një qendër e rëndësishme për zhvillimin e dijes dhe kërkimit shkencor.

Panelistët e pranishëm vlerësuan angazhimin për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe e cilësuan organizimin e Javës Ndërkombëtare Erasmus+ si një mundësi të shkëlqyer për ndarjen e eksperiencave dhe krijimin e partneriteteve të reja.

Gjatë javës do të zhvillohen aktivitete të pasura, duke përfshirë seminare, ngjarje kulturore dhe punëtori bashkëpunuese, që synojnë forcimin e lidhjeve ndërkombëtare dhe nxitjen e shkëmbimit të ideve.





